The Human Rights Advisory Panel
Building D, UNMIK HQ Prishtinë/Priština, Kosovo | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

MENDIM

Data e miratimit: 18 qershor 2010

Nr. i lëndës 01/07

Radovan PARLIĆ

kundër

UNMIK-ut

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, më 18 qershor 2010
Me anëtarët vijues të pranishëm:

Z. Marek NOWICKI, Kryetar
Z. Paul LEMMENS
Z. Christine CHINKIN

Të ndihmuar nga

Z. Rajesh TALWAR, Zyrtar ekzekutiv

Pas shqyrtimit të ankesës së sipërpërmendur, të paraqitur në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 të datës 23 mars 2006 për themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut,

Pas diskutimeve konstaton dhe rekomandon si vijon:

I. PROCEDURA PRANË PANELIT

1. Ankesa është paraqitur më 22 shkurt 2007 dhe është regjistruar në të njëjtën ditë.

2. Ankesa i është komunikuar PSSP-së më 19 mars 2008, duke i dhënë atij mundësinë të bëjë komente në emër të UNMIK-ut mbi pranueshmërinë dhe bazueshmërinë në pajtim me nenin 11.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 dhe Rregullës 30 të Rregullores së Punës së Panelit. PSSP-ja nuk e shfrytëzoi këtë mundësi.

3. Më 11 prill 2008 Paneli e shpalli ankesën të pranueshme.

4. PSSP-ja i dorëzoi komentet e tij për bazueshmërinë e ankesës më 11 qershor 2009. Ankuesi dha përgjigje për këto komente më 31 korrik 2009.

II. FAKTET

5. Ankuesi thekson se ai është punësuar nga ndërmarrja shoqërore "Tefik Çanga" (kompania) me seli në Ferizaj në vitin 1991. Duke u frikësuar nga lufta ai e lëshoi Kosovën në vitin 1999 dhe që atëherë ka jetuar si person i zhvendosur në Serbi.

6. Gjatë privatizimit të kompanisë, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) në tetor 2005 publikoi një listë prej 710 punëtorëve të cilët konsideroheshin se kanë të drejtë të marrin një pjesë të fitimeve nga privatizimi i kompanisë. Ankuesi nuk është përfshirë në këtë listë. Kompania është privatizuar në mënyrë të efektshme më 5 nëntor 2005.

7. Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (Dhoma e Posaçme) ka pranuar 2 ankesa në grup dhe 209 ankesa individuale, duke përfshirë edhe atë të ankuesit, kundër listës së AKM-së. Numri i përgjithshëm i personave që janë ankuar ishte 417. Ankesa e ankuesit është regjistruar më 21 nëntor 2005.

8. Në ankesën e tij drejtuar Dhomës së Posaçme, ankuesi theksoi se edhe pse ka pasur disa punëtorë serbë dhe punëtorë të përkatësive të tjera etnike në kompani, lista e punëtorëve që gëzonin këtë të drejtë nuk përfshinte asnjë emër të ndonjë personi serb apo nga një grup tjetër etnik. Ai argumenton se ka qenë i punësuar në kompani që nga viti 1991 dhe se ai është dashur të largohet nga Kosova në vitin 1999 "për arsyet e mirënjohura". Ai besonte se është diskriminuar, meqë emri i tij nuk ishte në listë, edhe pse ai ishte punëtor. Ai e la të hapur zbrazëtirën në formularin e ankesës për të shënuar ndonjë dokument që ai do të dorëzonte për të mbështetur faktin se ka qenë i punësuar nga kompania për më shumë se tri vite. Në vend të kësaj, ai theksoi se libreza e tij e punës mbeti në kompani. Më në fund, ai ia tërhoqi vëmendjen Dhomës së Posaçme në faktin se lista e punëtorëve mund të gjendej në regjistrat e ruajtur nga kompania. Bashkëngjitur në ankesën e tij ishte një certifikatë dorëzuar atij në vitin 2002 nga "dega e zyrës për persona të zhvendosur" nga kompania duke konfirmuar punësimin e tij më 9 qershor 1999, si dhe një kopje e librezës së tij shëndetësore.

9. Ankuesi thekson se ka marrë një thirrje më datë 24 prill 2006 për një seancë dëgjimore të dëshmive pranë Dhomës së Posaçme të caktuar më 2 maj 2006. Dhoma e Posaçme e udhëzoi ankuesin që të sjellë librezën e tij të punës, një deklaratë për diskriminimin dhe dëshmi të tjera. Dhoma e Posaçme tha se, nëse ankuesi nuk paraqitet, seanca dëgjimore megjithatë do të mbahej. Ankuesi nuk u paraqit.

10. Me një aktgjykim të datës 15 qershor 2006, Dhoma e Posaçme pranoi 43 ankesa të ankuesve të cilët kërkonin përfshirje në listën e punëtorëve që kishin të drejtë, refuzoi kërkesat e ankuesve të cilët kërkonin rishikimin e listës së publikuar të punëtorëve të cilët

kishin të drejtë në një pjesë të fitimit, dhe refuzoi 146 ankesa të ankuesve, duke përfshirë edhe atë të ankuesit për këtë rast, të cilët kërkonin përfshirje në listën e punëtorëve të cilët kishin të drejtë.

11. Dhoma e Posaçme konsideroi se ankesat përgjithësisht duhej të shqyrtohen sipas nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 të datës 9 maj 2003 mbi bartjen e të drejtës për shfrytëzim në pronën e paluajtshme shoqërore (më tutje i referohemi si "Rregullorja 2003/13").

12. Sipas kësaj dispozite, të ndryshuar me Rregulloren nr. 2004/45 më 19 nëntor 2004, 20 % e fitimeve nga shitja e aksioneve të një ndërmarrje shoqërore të privatizuar janë të rezervuara për punëtorët e kompanisë (neni 10.1). Shuma e rezervuar për punëtorët shpërndahet në mes të punëtorëve të cilët "kanë të drejtë", d.m.th. ata punëtorë të cilët janë të regjistruar si punëtorë në kohën e privatizimit dhe të cilët kanë qenë në listën e pagesave të kompanisë për jo më pak se tri vite (neni 10.4). Emrat e punëtorëve të regjistruar janë vendosur në një listë, të nxjerrë nga AKM-ja dhe të bërë publike (neni 10.3). Ish punëtorët të cilët nuk janë në listë mund të pretendojnë "se ata do të kishin qenë të regjistruar dhe të punësuar, po të mos i ishin nënshtruar diskriminimit" (neni 10.4). Punëtorët e tillë mund të paraqesin ankesë në Dhomën e Posaçme në pajtim me nenin 10.6.

13. Neni 10.6 i Rregullores 2003/13 parasheh që ankesat lidhur me listën e punëtorëve që kanë të drejtë ose shpërndarja e fondeve t'i nënshtrohen rishikimit nga Dhoma e Posaçme. Neni 10.6 (b) ka të bëjë me dëshmitë që duhet t'i paraqiten Dhomës së Posaçme nga ish punëtorët të cilët kërkojnë të përfshihen në listë: "Çdo ankesë e paraqitur në Dhomën e Posaçme për arsye të diskriminimit që është marrë si shkak për t'u përjashtuar nga lista e punëtorëve që kanë të drejtë duhet të shoqërohet me dëshmi të dokumentuara për diskriminimin e pohuar."

14. Në aktgjykimin e saj të datës 15 qershor 2006 Dhoma e Posaçme theksoi se neni 10.6 (b) i Rregullores 2003/13 ishte shfuqizuar me nenin 8.1 të Ligjit kundër diskriminimit (Ligji nr. 2004/3), i miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 19 shkurt 2004 dhe i shpallur nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) më 20 gusht 2004 (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2004/32 për shpalljen e Ligjit kundër diskriminimit, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës).

15. Ligji kundër diskriminimit ishte miratuar për të parandaluar diskriminimin dhe për të promovuar dhe vënë në fuqi parimin e trajtimit të barabartë të qytetarëve të Kosovës. Në dispozitat e tij relevante thuhet si vijon:

- Neni 8:

"Barra e dëshmisë

8.1. Kur personat të cilët konsiderojnë se ndaj tyre është bërë padrejtësi për shkak se për ata nuk është zbatuar parimi i trajtimit të barabartë, tregojnë fakte nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, i padituri është ai i cili duhet të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit për trajtim të barabartë.
8.2. Paragrafi 8.1 nuk e parandalon paraqitjen e dëshmive, të cilat janë më të favorshme për paditësit. Për më tepër, ankuesi mund të konstatojë apo mbrojë

lëndën e tij të diskriminimit në çdo mënyrë, duke përfshirë edhe mënyrën me dëshmi statistikore."

- Neni 11:

"11.1. Kur ky ligj të hyn në fuqi shfuqizon të gjitha ligjet e mëparshme në fuqi të kësaj fushe.
11.2. Dispozitat e legjislacionit të paraqitur ose të atij në fuqi për mbrojtjen e parimit për trajtim të barabartë akoma janë valide dhe duhet të zbatohen nëse ata janë më të favorshme se sa dispozitat në këtë Ligj."

16. Dhoma e Posaçme erdhi në konkludim për sa i përket zbatueshmërisë së nenit 8.1 të Ligjit kundër diskriminimit në bazë të arsyeve vijuese:

"Për të verifikuar faktin nëse Ligji kundër diskriminimit e shfuqizon Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13, neni 10.6 (b), kur kemi të bëjmë me arsyet e dëshmive të kërkuara për të dëshmuar diskriminimin, Dhoma, më 28.10.2005, kërkoi nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) të ofrojë sqarime për këtë çështje.

Më 11 janar 2006, PSSP-ja u përgjigj pozitivisht. Veçanërisht, ai shtoi: "Në pajtim me nenin 11 të Ligjit kundër diskriminimit, neni 8 i këtij Ligji i miratuar më pas, e shfuqizon nenin 10.6 (b) të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13."

Parimi i paraparë në nenin 8 të Ligjit kundër diskriminimit është ndryshe nga kërkesat për dëshmi të dokumentuara të parapara në nenin 10.6 (b) të Rregullores 2003/13.

Lidhur me ankesat e paraqitura, kur ankuesi nuk është përfshirë në listën e punëtorëve si pasojë e diskriminimit, neni 8.1 i Ligjit kundër diskriminimit parasheh qartë që të paraqiten faktet nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë."

17. Pas përcaktimit të ligjit të zbatueshëm lidhur me barrën e dëshmisë, Dhoma e Posaçme vazhdoi me shqyrtimin e secilës ankese veçmas. Në pjesën përkatëse të aktgjykimit lidhur me ankuesin në këtë rast thuhet:

"Radovan Parlić konfirmon se ai ishte punësuar në NPSH nga viti 1991 me një përvojë të përgjithshme të punës prej 14 vitesh. Ai nuk ka paraqitur asnjë fakt lidhur me datën e punësimit dhe nuk e ka paraqitur as deklaratën për diskriminimin. Edhe pse është thirrur me kohë ai nuk i është përgjigjur thirrjes për në gjyq.

I padituri kundërshtoi ankesën e ankuesit në bazë të faktit se kërkesat ligjore në pajtim me nenin 10.4 të Rregullores 2003/12 nuk janë plotësuar që ai të ketë të drejtë në 20% të fitimit.

Pas vlerësimit të dëshmive, Dhoma konstaton se ankesa e ankuesit nuk është e bazuar ligjërisht. Ai nuk ka paraqitur fakte në bazë të të cilave mund të supozohej diskriminimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë dhe nuk ka fakte se ai ka

punuar në kohën e privatizimit. Ankesa refuzohet meqë nuk mbështetet me fakte.

18. Dhoma e Posaçme e ka njoftuar ankuesin me aktgjykimin më 20 tetor 2006.

III. ANKESA

19. Ankuesi ankohet se vendimet e pafavorshme të AKM-së dhe të Dhomës së Posaçme në rastin e tij nuk morën parasysh të gjitha dëshmitë dhe rrethanat e ankuesit si person i zhvendosur, që si pasojë e privoi atë nga e drejta e tij materiale e cila e drejtë buronte nga procesi i privatizimit. Në këtë aspekt ai kërkon të drejtën e tij për të gëzuar në mënyrë të papenguar të drejtën e tij (neni 1 i Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (më tutje: KEDNJ)). Ai gjithashtu pohon se e drejta e tij për gjykim të drejtë (neni 6 § 1 i KEDNJ) është shkelur disa herë: Dhoma e Posaçme i caktoi një afat kohor jorealist për të nxjerrë librezën e punës dhe origjinalin e librezës së tij shëndetësore, meqë ai kishte marrë thirrje gjyqësore për 26 prill 2006 të marrë pjesë në seancë dëgjimore dhe të dorëzojë dëshmitë më 2 maj 2006; Dhoma e Posaçme nuk e konsideroi të nevojshme të urdhërojë kompaninë që të nxjerrë dëshmitë e kërkuara; Dhoma e Posaçme nuk i shqyrtoi dëshmitë e dorëzuara nga ankuesi dhe nuk shpjegoi pse nuk u dha ndonjë peshë atyre. Përfundimisht, ankuesi ankohet se Dhoma e Posaçme injoroi diskriminimin e drejtpërdrejtë të personave që u përkasin pakicave serbe dhe pakicave të tjera etnike. Ai thekson se nuk ka qenë në gjendje të vazhdojë të punojë në kompani për shkak të prejardhjes së tij serbe, që si pasojë e eliminoni atë *de facto* nga procesi i privatizimit. Në këtë aspekt, ai pohon se është shkelur parimi i mosdiskriminimit (neni 14 i KEDNJ).

IV. LIGJI

A. Pranueshmëria e ankesës

20. Në parashtresat e tij të datës 11 qershor 2009, të paraqitura pasi ankesa ishte shpallur e pranueshme, PSSP-ja bëri një vërejtje sa i përket pranueshmërisë së ankesës. Sipas PSSP-së, ankuesi ankohet për një aktgjykim të marrë nga Dhoma e Posaçme më 15 qershor 2006, kurse ankesa i është dorëzuar Panelit më 22 shkurt 2007. PSSP-ja e ftoi Panelin që të sigurohet se aktgjykimi i Dhomës së Posaçme i është dorëzuar ankuesit jo më vonë se gjashtë muaj para dorëzimit të ankesës së tij.

21. Me shkresën e datës 12 qershor 2009, Sekretariati i Panelit ia tërhoqi vëmendjen PSSP-së në faktin se ankuesi kishte nënshkruar fletëpranimin për aktgjykimin më 24 tetor 2006.

22. Me shkresën e datës 30 qershor 2009, PSSP-ja deklaroi se e ka tërhequr vërejtjen e tij.

B. Bazueshmëria e ankesës

1. Shkelja e pohuar e së drejtës për gjykim të drejtë (neni 6 § 1 i KEDNJ)

23. Ankuesi pohon shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNNJ, që në pjesët e tij përkatëse thuhet si vijon:

> "Në përcaktimin e të drejtave civile dhe obligimeve ..., çdo kush ka të drejtë në seancë dëgjimore të drejtë..... brenda një afati kohor të arsyeshëm nga [një] ... tribunal ..."

a. Argumentet pranë Panelit

24. Ankuesi pohon se Dhoma e Posaçme i dha atij një afat kohor jorealist për të nxjerrë librezën e punës dhe origjinalin e librezës së shëndetësisë, meqë atij i kishte ardhur thirrje gjyqësore me një urdhër të 24 prillit 2006 për të marrë pjesë në gjykim dhe për të dorëzuar dëshmi më 2 maj 2006. Ai pohon se sipas nenit 9.4 (b) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/13 të datës 13 qershor 2002 mbi themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë e Mirëbesimit (më tutje: Rregullorja 2002/13), Dhoma e Posaçme duhej t'i jepte atij "kohë të mjaftueshme për dorëzimin e dëshmive të dokumentuara", dhe se kjo kërkesë nuk ishte plotësuar, veçanërisht jo në situatën kur ai ishte person i zhvendosur, në pamundësi për t'u kthyer në Kosovë për të rimarrë librezën e punësimit, për shkak të mungesës së sigurisë dhe gjendjes së tij financiare.

25. Ai gjithashtu pohon se Dhoma e Posaçme nuk e konsideroi të nevojshme të urdhërojë kompaninë të japë dëshmitë e kërkuara, përkundër faktit se në pajtim me nenin 8.1 të Ligjit kundër diskriminimit i pandehuri është ai i cili duhet të dëshmojë se nuk ka pasur diskriminim. Ai gjithashtu pohon se Dhoma e Posaçme nuk kishte shqyrtuar dëshmitë e dorëzuara nga ai dhe nuk ka shpjeguar pse atyre nuk u ka dhënë ndonjë peshë. Është e vërtetë se Dhoma e Posaçme bëri me dije se ai nuk kishte dorëzuar deklaratë për diskriminimin, por nuk ekziston ndonjë rregullore me të cilën kërkohet deklaratë e tillë nga ankuesi.

26. Lidhur me njoftimin brenda një afati të shkurtër për seancën dëgjimore më 2 maj 2006, PSSP-ja pranon se sipas nenit 34.1 të Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2003/13 të datës 11 qershor 2003 për implementimin e Rregullores së sipërpërmendur nr. 2002/13 (më tutje: Urdhëresa administrative 2003/13), thirrja gjyqësore për dëgjimin e parë "u dorëzohet palëve jo më vonë se dy javë para datës së dëgjimit". Afati ligjor prej dy javësh për dorëzimin e thirrjes gjyqësore ishte shkurtuar, sikurse në një numër të madh të rasteve të tjera, për shkak të vëllimit të dëshmive që duhej të mblidheshin. Sido që të jetë, PSSP-ja argumenton se, nëse ankuesi kishte menduar se afati kohor për nxjerrjen e dëshmive të kërkuara dhe për paraqitjen pranë Dhomës së Posaçme ishte e pamjaftueshme, ai ka mundur të kërkojë shtyrjen e gjykimit në pajtim me nenin 34.2 të Urdhëresës administrative 2003/13. Asgjë nuk tregon se ankuesi ka bërë një kërkesë të tillë për shtyrjen e dëgjimit.

27. PSSP-ja gjithashtu thekson se vendimi i Dhomës së Posaçme ishte marrë në bazë të dëshmive të nxjerra nga ankuesi, që sipas mendimit të Dhomës së Posaçme, ishin të pamjaftueshme për të mbështetur ankesën e tij se ai e ka plotësuar kushtin lidhur me vitet punësimit në atë kompani. Për më tepër, ankuesi nuk paraqiti "deklaratë për diskriminimin" për të mbështetur ankesën e tij se ai ishte diskriminuar për shkak të prejardhjes së tij etnike serbe dhe, si pasojë, nuk kishte pasur mundësi të paraqitet në punë nga viti 1999 e tutje. PSSP-ja konsideron se, edhe nëse ky diskriminim në fakt të kishte ndodhur, ai sigurisht se nuk do të përbënte shkelje të të drejtave të njeriut të bërë nga AKM-ja apo nga Dhoma e Posaçme, por do të ishte diskriminim që ishte si pasojë e rrethanave të Kosovës pas konfliktit të vitit 1999.

b. Vlerësimi i Panelit

1. Njoftimi për seancën dëgjimore

28. Përderisa ankuesi argumenton se, si person i zhvendosur që jeton në Serbi me liri të kufizuar të lëvizjes në kohën përkatëse, ai nuk ka pasur mundësi të marrë dokumentacionin e kërkuar nga Dhoma e Posaçme brenda afatit kohor të caktuar nga ajo, Paneli potencon dispozitat vijuese të Rregullores 2002/13 dhe të Urdhëresës administrative 2003/13:

- nenet 7, 8 dhe 9 të Rregullores 2002/13, në versionin e tyre në kohën e procedurës pranë Dhomë së Posaçme, parashohin si vijon:

> "Neni 7. Rregullorja e punës pranë Dhomës së Posaçme
>
> Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm do të nxjerrë rregullat për drejtimin e procedurës pranë Dhomës së Posaçme përmes nxjerrjes së një urdhërese administrative. Rregullat e tilla i sigurojnë palës mundësi kuptimplota që ankesa e saj të gjykohet në mënyrë të paanshme dhe transparente brenda një periudhe kohore të arsyeshme dhe në pajtim me normat e caktuara me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe duke marrë parasysh standardet e përgjithshme të pranuara ndërkombëtarisht.
>
> Neni 8. Nxjerrja e dëshmive dhe drejtimi i gjykimeve
>
> 8.1. Dhoma e Posaçme mund të urdhërojë çdo person në Kosovë të dorëzojë dokumente, të japë dëshmi, ose përndryshe të sigurojë informacione relevante të nevojshme për gjykimin e një rasti, në pajtim me rregullat procedurale të cilat do të shpallen sipas nenit 7.
> 8.2. Dhoma e Posaçme mund të ngarkojë një panel të përbërë me jo më pak se dy nga anëtarët e tij, nga të cilët njëri do të jetë gjyqtar ndërkombëtar, për grumbullimin e dëshmive dhe/ose drejtimin e gjykimeve. Në lëndët ku shuma e diskutueshme nuk kalon dhjetë mijë euro (€ 10,000), Dhoma e Posaçme mund të ngarkojë një gjyqtar. Dëshmitë e marra pranë një paneli ose një gjyqtari sipas këtij paragrafi konsiderohen se janë të dorëzuara në Dhomën e Posaçme.
>
> Neni 9. Vendimet e Dhomës së Posaçme
>
> 9.1 – 9.3. (…)
> 9.4. Dhoma e Posaçme mund të marrë vendim sipas nenit 9.2 pa mbajtur gjykim për të marrë dëshmi nga dëshmitarët dhe dëshmi të tjera nëse:
> (a) ankuesi ka paraqitur ankesë për të cilën ligjërisht nuk mund të bëhet asnjë lehtësim, duke marrë si të vërtetë pohimet në parashtresën e ankuesit ose
> (b) pasi që palëve t'u ofrohet kohë e mjaftueshme për dorëzimin e dëshmive të dokumentuara, Dhoma e Posaçme konstaton se nuk qëndrojnë konteste të vërteta të fakteve materiale të nevojshme për vendosjen e rastit.

9.5 – 9.7. (…)”

- Nenet 34 dhe 64 të Urdhëresës administrative 2003/13, të nxjerrë në pajtim me nenin 7 të Rregullores 2002/13, parashohin si vijon:

“Neni 34. Njoftimi për gjykim

34.1. Palët ftohen në gjykimin e parë me njoftim me shkrim. Njoftimi përfshin datën, kohën dhe vendin e gjykimit dhe palëve u dorëzohet jo më vonë se dy javë para datës së gjykimit.
34.2. Me kërkesë të cilësdo nga palët, gjyqtari kryesues e shtyn gjykimin nëse pala tregon se është e parandaluar që të paraqitet në gjykim për një arsye të rëndësishme. Palës tjetër mund t’i jepet mundësia që të jep komentet e saj për kërkesën. Gjyqtari kryesues vendos për shtyrjen e gjykimit pa mbajtur gjykim dhe vendimi i tillë u dërgohet palëve. Kur miratohet kërkesa për shtyrje, gjyqtari kryesues mund të urdhërojë që pala kërkuese të paguaj shpenzimet që ajo palë ia ka shkaktuar palës tjetër apo palëve.

Neni 64. Ankesat lidhur me listat e punëtorëve që kanë të drejtë

64.1. Procedura për ankesat e paraqitura sipas nenit 10.6 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 të datës 9 maj 2003 mbi bartjen e së drejtës për shfrytëzim në pronën e paluajtshme shoqërore (një ankesë nga ‘neni 10.6’) do të udhëhiqen me këtë nen. Nenet 19, 20, 22.1-22.6, 23, 32, 33 dhe 45-48 zbatohen për një ankesë të nenit 10.6.
64.2. Një ankesë e nenit 10.6 është me shkrim dhe përfshin:
(a) Emrin (at) e individit apo individëve në emër të të cilit/ëve është paraqitur ankesa (‘ankuesi(it)’);
(b) Adresa për dërgimin e shkresave ankuesit (ve);
(c) Arsyet për ankesën lidhur me listën e punëtorëve të cilët kanë të drejtë, të përcaktuar nga Agjencia, dhe/ose shpërndarja e fondeve nga llogaria e dorëzanit të paraparë në nenin 10.5 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 dhe
(d) Të gjitha dëshmitë e dokumentuara në mbështetje të ankesës së nenit 10.6, duke përfshirë, nëse është e mundur, dëshmitë e dokumentuara të kërkuara me nenin 10.5 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13.
64.3 – 64.5. (…)
64.6. Seanca gjyqësore mbahet me gojë, përveç nëse ankuesi kërkon me shkrim që të mos mbahet seancë gjyqësore me gojë dhe gjyqtari kryesues e pranon një kërkesë të tillë. Nëse mbahet seancë gjyqësore me gojë, Dhoma e Posaçme e informon ankuesin(it) dhe Agjencinë për datën e seancës së tillë përmes njoftimit me shkrim.
64.7 – 64.8. (…)”

29. Paneli bën me dije se, për procedurat e zakonshme pranë Dhomës së Posaçme, neni 34.1 i Urdhëresës administrative 2003/13 parasheh njoftim prej dy javësh për gjykimin kur duhet të nxjerrën dëshmitë. Mirëpo, nga neni 64.1 i kësaj urdhërese administrative del se neni në fjalë 34 nuk është i zbatueshëm në procedurat që kanë të bëjnë me ankesat kundër listës së

punëtorëve që kanë të drejtë. Për procedurat e tilla nuk është paraparë kohë minimale për njoftimin e gjykimit. Mirëpo, e drejta në gjykim të drejtë nënkupton që njoftimi t'i sigurojë ankuesit një mundësi të mjaftueshme që ai të veprojë në përputhje me urdhëresën e Dhomës së Posaçme.

30. Në rastin konkret, nga dosja e lëndës së Dhomës së Posaçme del se më 24 prill 2006 gjyqtari raportues dha urdhër duke e ftuar ankuesin që të paraqitet në gjykim të caktuar më 2 maj 2006 dhe të paraqesë librezën e tij të punës, deklaratën për diskriminim, dhe dëshmi të tjera. Kjo thirrje u dërgua më 25 prill 2006 me një shkresë të regjistruar dërguar ankuesit. Në Dhomën e Posaçme nuk është kthyer ndonjë fletëdërgesë.

31. Për të përmbushur kërkesën e gjyqtarit raportues për të paraqitur dëshmi të caktuara, ankuesi do të duhej të bënte aranzhimet e nevojshme për të marrë librezën e tij të punës. Ankuesi është person i zhvendosur i cili jeton jashtë Kosovës, dhe pranë Dhomë së Posaçme nuk është përfaqësuar nga ndonjë avokat. Ai pohon se nuk ka pasur mundësi të kthehet në Kosovë që ai vet ta merr librezën e tij të punës, për shkak të mungesës së sigurisë dhe gjendjes së tij financiare. Sa i përket kësaj çështjeje atë nuk e ka kundërshtuar PSSP-ja.

32. Është e paqartë se kur në të vërtetë ankuesi e ka marrë thirrjen gjyqësore. Paneli konsideron se ai ka mundur ta merr pas datës së gjykimit. Si do që të jetë, duke pasur parasysh situatën specifike të ankuesit si person i zhvendosur, i cili praktikisht nuk ka mundur të udhëtojë për në Kosovë, njoftimi prej një jave për t'u paraqitur në Dhomën e Posaçme dhe për të paraqitur dokumentacionin përkatës ishte tepër i shkurtër, meqë afati i tillë kohor nuk e lejoi atë të përgatisë rastin e tij në mënyrë adekuate.

33. PSSP-ja argumenton se ankuesi ka mundur të kërkojë shtyrjen e gjykimit. Mirëpo, Paneli bën me dije se urdhri i 24 prillit 2006 nuk përmend një mundësi të tillë. Në të kundërtën, në mënyrë eksplicite theksonte se gjykimi do të mbahej ashtu siç ishte caktuar, edhe nëse ankuesi nuk paraqitet. Për më tepër, derisa neni 34.2 i Urdhëresës administrative 2003/13 parasheh mundësinë që cilado palë të kërkojë shtyrjen e gjykimit, dhe se kërkesa e tillë miratohet "nëse pala tregon se është e parandaluar që të paraqitet në gjykim për një arsye të rëndësishme", neni 34 nuk zbatohet në procedurat lidhur me ankesat kundër listave të punëtorëve që kanë të drejtë. Prandaj, Paneli mendon se mundësia e ankuesit që të kërkojë shtyrjen nuk ka qenë mundësi realiste në atë kohë.

34. Prandaj, Paneli konkludon se në këtë aspekt ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNJ.

2. Shqyrtimi i rastit

35. Për sa i përket ankesës se Dhoma e Posaçme nuk mori parasysh të gjitha dëshmitë dhe rrethanat relevante dhe nuk e urdhëroi kompaninë të nxjerrë dëshmitë e kërkuara, Paneli që në fillim dëshiron të sqarojë se vlerësimin e vet të fakteve nuk e zëvendëson me atë të Dhomës së Posaçme. Si rregull e përgjithshme, gjykatat kompetente duhet të vlerësojnë dëshmitë që janë pranë tyre si dhe rëndësinë e dëshmive të cilën palët kërkojnë ta paraqesin, dhe Paneli do të ndërhyjë vetëm kur vlerësimi i dëshmive apo konstatimi i fakteve nga gjykatat mund të vihet në dyshim nga arsyet se ata kanë qenë të paarsyeshme apo në ndonjë mënyrë tjetër kanë qenë arbitrare (shih Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (më tutje: GJEDNJ), *I.J.L. dhe të Tjerët v. Mbretërisë së Bashkuar*, nos. 29522/95, 30056/96 dhe 30574/96, aktgjykim i 19 shtatorit 2000, § 99, *KEDNJ*, 2000-IX). Detyrë e Panelit është të verifikojë nëse procedurat në

tërësi, duke përfshirë edhe mënyrën në të cilën u vlerësuan dëshmitë, ishin të drejta (GJEDNJ, *Ebanks v. Mbretëria e Bashkuar*, nr. 36822/06, aktgjykim i 26 janarit 2010, § 74).

36. Në rastin konkret, nga shkresat e lëndës pranë Dhomë së Posaçme duket se në ankesën e pranuar më 21 nëntor 2005 ankuesi argumentoi se ai kishte qenë i punësuar nga kompania që nga viti 1991, dhe se ai kishte një numër të përgjithshëm prej 14 vitesh shërbim (*sic*). Ai gjithashtu thekson se ishte dashur të braktisë territorin e Kosovës në qershor 1999 "për arsyet e mirënjohura" dhe përkohësisht të zhvendoset në territorin e Serbisë, ku ai kishte qëndruar që nga ajo datë, "duke pritur përmirësimin e kushteve për një jetesë të sigurt dhe normale në Kosovë, ku [ai] do të kishte dëshirë të kthehej dhe të jetonte në shtëpinë e [tij] ". Ai theksoi se besonte se ishte i diskriminuar nga fakti se emri i tij nuk ishte përfshirë në listën e publikuar të punëtorëve që kanë të drejtë në përqindjen e caktuar. Sa u përket dëshmive në mbështetje të faktit se ai ishte punësuar për më shumë se tri vite, ai tha se libreza e tij e punës kishte mbetur në kompani, dhe se lista e punëtorëve në kompani mund të gjendej në regjistrat e punëtorëve që ruheshin në njësinë e tij punuese. Dhoma e Posaçme e refuzoi ankesën nga shkaku se ankuesi nuk dëshmoi se kishte punuar në kohën e privatizimit, dhe duke marrë parasysh se ai nuk dorëzoi deklaratë për diskriminim, ai nuk paraqiti fakte në bazë të të cilave do të mund të prezumohej diskriminim i drejtpërdrejtë apo i tërthortë.

37. Sipas nenit 8.1 të Ligjit kundër diskriminimit, ankuesi, i cili nuk ishte duke punuar më në kompani në kohën e privatizimit (2005), duhej të tregojë fakte nga të cilët mund të prezumohej se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthorët", në të cilin rast AKM—ja është ajo e cila do të duhej të hedhë poshtë prezumimin, *d.m.th*. të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.

38. Nga aktgjykimi i Dhomës së Posaçme të datës 15 qershor 2006 rezulton se Dhoma e Posaçme pranoi ankesat e disa ankuesve të tjerë, edhe pse ata nuk kanë pasur mundësi të nxjerrin librezat e tyre të punës. Dhoma e Posaçme pranoi në këto raste se diskriminimi mund të rezultojë nga "situata e krijuar e pas luftës dhe pamundësia e [ankuesit] të kthehet në punë për shkak të shqetësimeve të sigurisë [së tij] personale" dhe nga fakti "se emri [i ankuesit] nuk ishte përfshirë në listën e shpallur edhe pse [ai] i plotësonte kërkesat ligjore për t'u përfshirë në listë". Këto ishin pikërisht arsyet në të cilat ankuesi gjithashtu e mbështet ankesën e tij në këtë rast.

39. Duket se arsyeja e vetme pse Dhoma e Posaçme konsideroi se ankuesi nuk tregoi fakte që rezultoi me zhvendosjen e barrës së dëshmisë, të paraparë në nenin 8.1 të Ligjit kundër diskriminimit, ishte se ai nuk e dorëzoi "deklaratën e diskriminimit". Duke e përdorur këtë term, Dhoma e Posaçme qartazi iu referua njërit nga dokumentacionet e kërkuara nga gjyqtari raportues në urdhrin e tij të datës 24 prill 2006. Në këtë aspekt, Dhoma e Posaçme gjithashtu vuri në pah se ankuesi, edhe pse i thirrur me kohe, nuk iu përgjigj thirrjes.

40. Paneli është i goditur nga fakti se, edhe pse ankuesi në ankesën e tij ia bëri të qartë Dhomës së Posaçme arsyet në të cilat e bazoi pohimin e tij se ishte viktimë e diskriminimit, Dhoma e Posaçme nuk e ka marrë parasysh këtë deklaratë. Duket se Dhoma e Posaçme do ta kishte marrë parasysh një pohim të tillë vetëm nëse do të ishte konfirmuar formalisht në një "deklaratë për diskriminim" të një date të mëvonshme.

41. Për aq sa vendimi i Dhomës së Posaçme duhet të interpretohet ashtu që të nënkuptojë se deklarata e diskriminimit do të mund të merrej parasysh vetëm nëse do të mund të

konfirmohej gojarisht nga ankuesi gjatë gjykimit, ai do t'ju nënshtrohej kritikave të paraqitura lart për sa i përket njoftimit për gjykim (§§ 29-34).

42. Paneli konstaton se, me mosmarrjen parasysh të deklaratës së bërë nga ankuesi në ankesën e tij fillestare, dhe duke e bazuar vendimin në pohimin për mosparaqitjen e dëshmive të kërkuara nga ana e ankuesit, Dhoma e Posaçme nuk i siguroi atij gjykim të drejtë.

43. Prandaj, Paneli konkludon se ka pasur gjithashtu shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNJ në këtë aspekt.

2. Shkelja e pohuar e së drejtës për mbrojtjen e pronës (neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ)

44. Ankuesi pohon shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ. Në fjalinë e parë të paragrafit të parë të këtij neni thuhet si vijon:

> "Çdo person fizik apo juridik ka të drejtë të gëzojë në mënyrë të papenguar pronën e tij."

a. Argumentet pranë Panelit

45. Ankuesi pohon se AKM-ja dhe Dhoma e Posaçme nuk morën parasysh sipas rregullit të gjitha dëshmitë e dorëzuara nga ai. Dhe as nuk u dhanë rëndësi të mjaftueshme rrethanave të ankuesit si person i zhvendosur, i cili nuk kishte mundësi të marrë librezën e tij të punës që i kishte mbetur në kompani në Kosovë. Si pasojë, ai ishte privuar nga e drejta e tij materiale që buronte nga procesi i privatizimit.

46. PSSP-ja thekson se Dhoma e Posaçme konsideroi se ankuesi nuk paraqiti dëshmi të mjaftueshme në mbështetje të ankesës së tij se i plotësonte kushtet për t'u konsideruar si punëtorë i cili ka të drejtë të përfshihet në listë. Dhoma e Posaçme gjithashtu theksoi se ankuesi nuk paraqiti "deklaratë për diskriminimin" për të mbështetur ankesën e tij se kishte pësuar nga diskriminimi. PSSP-ja konkludon se as vendimi i AKM-së as aktgjykimi i Dhomës së Posaçme nuk përbëjnë shkelje të së drejtës së ankuesit në pronë.

b. Vlerësimi i Panelit

47. Paneli thekson se ngritet çështja nëse neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ është i zbatueshëm. Koncepti i "pronësisë" në fjalinë e parë në paragrafin e parë të kësaj dispizite ka kuptim autonom. Siç ka theksuar GJEDNJ në shumë raste, neni 1 i Protokollit nr. 1 zbatohet vetëm për pronat ekzistuese të personit. Është e vërtetë se, në rrethana të caktuara, një "pritje legjitime" e marrjes së një "aseti" mund gjithashtu të gëzojë mbrojtjen e nenit 1 të Protokollit nr. 1, me kusht që të ketë bazë të mjaftueshme për interesimin e pronës në ligjin në fuqi, për shembull kur kemi praktikë gjyqësore të vendosur të gjykatave vendore që konfirmojnë ekzistimin e saj (GJEDNJ (Grand Chamber), *Kopecký v. Slovakia*, nr. 44912/98, aktgjykim i datës 28 shtator 2004, § 52, *KEDNJ*, 2004-IX). Mirëpo, nuk mund të themi se kemi pritje legjitime kur kemi kontest për interpretimin e saktë dhe zbatimin e ligjit vendor dhe parashtresat e ankuesit më pas refuzohen nga gjykatat (GJEDNJ (Grand Chamber), *Kopecký v. Slovakia*, aktgjykim i cituar lart, § 50; GJEDNJ (Grand Chamber), *Anheuser-Busch Inc. v. Portugalia*, aktgjykim i 11 janarit 2007, nr. 73049/01, § 65).

48. Në këtë rast, Dhoma e Posaçme theksoi se ankuesi nuk paraqiti fakte për të mbështetur ankesën e tij se ai kishte të drejtë në një pjesë të fitimeve nga privatizimi i kompanisë. Kjo zakonisht duhet të shpie në konkludimin se ankuesi nuk kishte "pronë" në kuptim të fjalisë së parë të paragrafit të parë të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ.

49. Megjithatë, nuk mund të përjashtohet që UNMIK-u të mbahet përgjegjës për efektin e kundërt në interesat pronësore të ankuesit të shkaktuar nga vendimi i marrë nga Dhoma e Posaçme, nëse vendimi i kësaj të fundit do të konsiderohej si arbitrar apo i paarsyeshëm (krahaso GJEDNJ, *Beshiri dhe të Tjerët v. Shqipëria*, nr. 7352/03, aktgjykim i datës 22 gusht 2006, § 89). Mirëpo, shqyrtimi i kësaj çështjeje në masë të madhe do të koincidente me shqyrtimin e ankesës relevante sipas nenit 6 § 1 të KEDNJ (§§ 35-43). Paneli konstatoi se ankuesi nuk pati gjykim të drejtë lidhur me shqyrtimin e rastit të tij. Si pasojë, nuk e konsideron të nevojshme të vendosë për çështjen nëse ankuesi kishte të drejtë në kuptim të nenit 1 të Protokollit nr. 1, dhe prandaj edhe të japë mendim për ankesën në bazë të atij neni (shih GJEDNJ, *Glod v. Rumania*, nr. 41134/98, aktgjykim i 16 shtatorit 2003, § 46; GJEDNJ, *Albina v. Rumania*, nr. 57808/00, aktgjykim i 28 prillit 2005, § 43).

3. Pohimi i shkeljes së të drejtës për mos-diskriminim (neni 14 i KEDNJ lidhur me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ dhe neni 6 § 1 i KEDNJ)

50. Ankuesi pohon shkelje të nenit 14 të KEDNJ, ku në pjesët e tij relevante thuhet si vijon:

> "Gëzimi i të drejtave dhe lirive të parapara në këtë Konventë do të sigurohen pa diskriminim në asnjë bazë siç është …prejardhja nacionale apo shoqërore…"

Paneli do ta shqyrtojë nenin 14 të KEDNJ në kombinim me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ dhe nenin 6 § 1 të KEDNJ.

a. Argumentet pranë Panelit

51. Ankuesi pohon se Dhoma e Posaçme e injoroi tërësisht ekzistimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë të personave të pakicave etnike serbe dhe pakicave të tjera etnike. Ky diskriminim është një fakt i njohur përgjithësisht, për të cilin nuk kërkohet ndonjë dëshmi e veçantë. Ankuesi gjithashtu argumenton se ai duhej ta braktiste Kosovën dhe nuk kishte mundësi të kthehet në kompani dhe të vazhdojë kryerjen e aktiviteteve punuese për shkak të prejardhjes së tij serbe. Nëse gjendja e sigurisë do t'ju mundësonte personave të komuniteteve etnike pakicë serbe dhe të tjera të qëndronin në këtë vend, ai do të kishte mbetur në listën e pagesave të kompanisë, dhe kështu do të kishte të drejta të plota në një pjesë të fitimeve që do të buronin nga privatizimi i kompanisë. Si rezultat i pamundësisë së tij për t'u kthyer në punë, ai *de facto* ishte eliminuar nga procesi i privatizimit. Të kërkosh të tregohet në mënyrë të detajuar diskriminimi, bazuar në rrethana konkrete, i të komunitetet e cenueshme pakicë në situatë shumë të pajustifikueshme.

52. Siç është treguar lart, PSSP-ja thekson se në procedurat pranë Dhomës së Posaçme, ankuesi nuk paraqiti "deklaratë për diskriminimin" për të mbështetur ankesën e tij se ai kishte qenë i diskriminuar për shkak të prejardhjes së tij etnike serbe dhe, si pasojë, nuk kishte pasur mundësi të paraqitet në punë nga viti 1999 e tutje. PSSP-aj gjithashtu konsideron se, edhe nëse ky diskriminim do të kishte ndodhur, ai sigurisht se nuk do të përbënte shkelje të të

drejtave të njeriut të kryer nga AKM-ja apo nga Dhoma e Posaçme, por do të ishte diskriminim që do të ishte pasojë e rrethanave të situatës në Kosovë pas konfliktit të vitit 1999.

b. Vlerësimi i Panelit

53. Paneli përkujton se sipas nenit 10.4 të Rregullores nr. 2004/45 të datës 19 nëntor 2004 ish punëtorët të cilët nuk janë në listë, megjithatë mund të ankohen "se ata do të kishin qenë të regjistruar dhe të punësuar, po të mos kishin qenë të diskriminuar" (shih lart, § 12). Ankuesi argumenton se është dashur t'i jetë mjaft e qartë Dhomës së Posaçme se për shkak të prejardhjes së tij serbe ai ishte i obliguar që ta braktisë Kosovën, dhe kështu për shkak të diskriminimit ai më nuk ishte i punësuar në kohën e privatizimit. Sipas ankuesit Dhoma e Posaçme nuk e pranoi se ankuesi kishte qenë i diskriminuar, dhe kështu ajo vetë e shkeli të drejtën për të mos u diskriminuar.

54. Paneli konsideron se ankuesi në thelb ankohet për moskorrigjimin e një pabarazie ekzistuese nga Dhoma e Posaçme, viktimë e së cilës ishin ankuesi dhe ish punëtorë të tjerë serbë.

55. Një rregull e përgjithshme në fuq, edhe pse siç duket është neutrale, mund të ketë efektin e trajtimit të njerëzve ndryshe, *p.sh*. në bazë të prejardhjes së tyre etnike. Kur një grup i personave, për shkak të prejardhjes së tyre etnike, është në pozitë të cenueshme krahasuar me personat me prejardhje tjetër, autoritetet kompetente janë të obliguar t'u kushtohen në mënyrë të veçantë nevojave specifike të atij grupi të caktuar. Ky përkushtim i veçantë kërkohet në kornizën rregullative përkatëse dhe në vendimet në rastet e caktuara (konsulto, lidhur me situatën e romëve në një sërë shtetesh të Evropës qendrore dhe lindore, GJEDNJ (Grand Chamber), *D.H. dhe të Tjerët v. Republika Çeke*, nr. 57325/00, aktgjykim i 13 nëntorit 2007, § 181; GJEDNJ (Grand Chamber), *Oršuš v. Kroacia*, nr. 15766/03, aktgjykim i 16 marsit 2010, § 148).

56. Paneli thekson se sipas PSSP-së, edhe nëse ankuesi ka qenë i diskriminuar, ky diskriminim do të ishte pasojë e rrethanave të situatës pas konfliktit të vitit 1999 në Kosovë dhe nuk do të nënkuptonte ndonjë përgjegjësi të UNMIK-ut, në emër të AKM-së ose Dhomës së Posaçme. Paneli konsideron se argumenti i tillë nuk është përkatës. Edhe nëse diskriminimi rezultoi nga një situatë për të cilën UNMIK-u nuk është përgjegjës, kjo nuk e zvogëlon obligimin e tij që të shqyrtojë në mënyrë të veçantë nevojat specifike të ish punëtorëve të zhvendosur në rastet e privatizimit.

57. Mirëpo, nuk është e nevojshme që të vazhdohet tutje me shqyrtimin e ankesës sipas nenit 14 të KEDNJ. Paneli thekson se kjo ankesë përsëri ka të bëjë me mënyrën se si Dhoma e Posaçme e shqyrtoi rastin. Duke marrë parasysh konkluzionet e saj lidhur me nenin 6 § 1 të KEDNJ (shih §§ 35-43) Paneli konsideron se nuk ka arsye të shqyrtohet ndarazi nëse ankuesi ishte gjithashtu viktimë e diskriminimit në bazë të prejardhjes së tije etnike në kundërshtim me nenin 14 të KEDNJ, në kombinim qoftë me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ ose nenit 6 § 1 të KEDNJ.

V. REKOMANDIMET

58. Paneli përkujton se ka zbuluar se ankuesi nuk ka pasur përfitimin e garancive në nenin 6 § 1 të KEDNJ në procedurat pranë Dhomës së Posaçme. Derisa Paneli nuk mund të spekulojë

për rezultatin e procedurës nëse pozicioni do të ishte ndryshe, nuk e sheh të paarsyeshme që ankesën ta konsiderojë si një ankesë që ka humbur mundësi reale. Kësaj duhet shtuar dëmin jo-monetar që një konstatim i thjeshtë i shkeljes së të drejtës njerëzore të ankuesit për gjykim të drejtë nuk është i mjaftueshëm për ta vërtetuar këtë (shih GJEDNJ (Grand Chamber), *Pélissier dhe Sassi v. Franca*, nr. 25444/94, aktgjykim i datës 25 mars 1999, § 80, *KEDNJ*, 1999-II; GJEDNJ, *B.M v. Franca*, nr.44069/98, aktgjykim i 2 tetorit 2001, § 74, *GJEDNJ*, 2001-X).

59. Paneli konsideron se UNMIK-u duhet t'i japë ankuesit kompensim adekuat.

PËR ARSYET VIJUESE,

Paneli, unanimisht,

- KONSTATON SE KA PASUR SHKELJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT LIDHUR ME NJOFTIMIN PËR GJYKIMIN DHE VLERËSIMIN E DËSHMIVE;

- KONSTATON SE NUK KA NEVOJË TË SHQYRTOHET ANKESA LIDHUR ME SHKELJEN E NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR. 1 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT;

- KONSTATON SE NUK KA NEVOJË TË SHQYRTOJË ANKESËN LIDHUR ME SHKELJEN E NENIT 14 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, LIDHUR ME NENIN 1 TË PROTOKOLLIT NR. 1 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT OSE NENIN 6 § 1 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT;

- REKOMANDON QË UNMIK-U TË NDËRMARRË MASAT VIJUESE:
a. T'I JAPË KOMPENSIM ADEKUAT ANKUESIT PËR DËMET MONETARE DHE JO-MONETARE;
b. TË NDËRMERR MASA TË MENJËHERSHME DHE EFEKTIVE PËR IMPLEMENTIMIN E REKOMANDIMIT TË PANELIT DHE TË NJOFTOJË ANKUESIN DHE PANELIN PËR ZHVILLIMET E MËTEJSHME PËR KËTË RAST.

Rajesh TALWAR
Zyrtar ekzekutiv

Marek NOWICKI
Kryetar